



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

## INFORMACION I NEVOJSHËM MBI APLIKIMIN PËR PËRFAQËSUES NË KOMITETET E PROGRAMIT HORIZON 2020 DHE KOMITETET ERA

1. I interesuari për të vepruar si përfaqësues në komitetet e programit H2020 dhe në komitetet ERA (fushat tematike sipas shtojcave 1 dhe 1A bashkëlidhur) duhet të dërgojë përmes postës shpresore në AKKSHI (Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacion) brenda periudhës 1-31 tetor dokumentet si vijon:
  - a. kërkesën për shprehje interesi për të vepruar si përfaqësues i Shqipërisë në komitetet e programit H2020 ose në komitetet ERA,
  - b. jetëshkrimin e tij/saj sipas formatit Europass,
  - c. dokumente mbështetëse që provojnë veprimtarinë e tij/saj kërkimore-shkencore, apo eksperiencë në sektorin përkatës,
  - d. autorizimin nga punëdhënësi – sipas shtojcës 3 bashkëlidhur – që i lejon të veprojë si përfaqësues në komitetet e programit H2020 dhe në komitetet ERA në kuadër të punësimit të tij në institucionin punëdhënës.
2. Përfaqësuesit në strukturat e ERA-s në përputhje me misionin e tyre, kryejnë këto funksione:
  - a. marrin pjesë rregullisht në takimet e strukturave të ERA-s të thirrura nga KE, duke u njohur paraprakisht me agjendën e takimit;
  - b. japin mendim mbi çështjet që shtrohen për diskutim;
  - c. ndihmojnë për bashkërendimin e politikave kombëtare të kërkimit dhe novacionit dhe sigurojnë që politikat kombëtare të përputhen me politikat e ERA-s;
  - d. ofrojnë në një fazë të hershme këshilla për identifikimin dhe hartimin e prioriteteve strategjike për zhvillimin e ERA-s, duke përfshirë programet kuadër dhe nismat e tjera të rëndësishme të BE-së, ato ndërqeveritare dhe kombëtare;
  - e. ofrojnë këshilla për orientimin e politikave të ardhshme dhe ndërthurjen ndërmjet politikave ekzistuese në nivel kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar, duke kontribuar në zhvillimin e ERA-s;
  - f. identifikojnë nevojën për vlerësim të pavarur të politikave të kërkimit që lidhen me ERA dhe përdorin rezultatet e këtyre vlerësimeve për të bërë rekomandime për afrimin e mëtejshëm me parimet e ERA-s;
  - g. informojnë AKKSHI dhe DIKMA, të paktën dy javë para takimit, lidhur me agjendën e takimit të parashikuar, tematikën dhe qëllimin, duke evidentuar qartë detyrimet e MASR dhe koordinojnë me ta për qëndrimin, që duhet të mbajnë në emër të MASR;
  - h. raportojnë pranë AKKSHI dhe DIKMA jo më vonë se shtatë ditë pas zhvillimit të takimit duke dërguar në formë elektronike një relacion të përmbledhur deri dy faqe (në format elektronik), i cili të përmbajë të dhënat për qëllimin dhe objektin e takimit, për ecurinë e bisedimeve, për rekomandimet përkatëse për çështjet e diskutuara, sugjerimet për hapa të mëtejshëm për t'u ndërmarrë dhe planifikimin e punës në vijim;
  - i. raportojnë brenda datës 30 qershor dhe 31 dhjetor të çdo viti pranë AKKSHI-së mbi pjesëmarrjen e tyre në takimet sipas fushës tematike të kërkimit shkencor që përfaqësojnë,

dhe gjithë punën e kryer si përfaqësues në komitetet H2020 dhe ERA, sipas treguesve të përcaktuar në shtojcën 6 bashkëlidhur, si dhe të përcjellin propozimet përkatëse në kuadër të përmirësimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin H2020 dhe rritjes së numrit të aplikimeve dhe përfituesve të projekteve.

3. Përfaqësuesit në komitetet e programit H2020 kryejnë këto funksione:
  - a. marrin pjesë rregullisht në takimet vjetore të komitetit tematik ku bëjnë pjesë, organizuar nga Komisioni Evropian;
  - b. marrin pjesë në mbledhjet që realizon AKKSHI si koordinatori kombëtar i H2020;
  - c. janë të mirinformuar për objektivat, parimet dhe përmbajtjen e atij komiteti të H2020, për të cilën ai/ajo është emëruar si përfaqësues i asaj fushe në kuadër të H2020;
  - d. mbajnë kontakte me homologët e fushës në vendet e tjera dhe marrin pjesë aktivisht në rrjete me karakter ndërkombëtar;
  - e. mbajnë kontakte të vazhdueshme me AKKSHI dhe MASR (pikat e kontaktit për zbatimin e marrëveshjes H2020 në Drejtorinë e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës - DIKMA) mbi politikat kombëtare në kërkimin shkencor dhe novacionin, me qëllim që të mbajë qëndrimin e duhur në këto komitete;
  - f. informojnë AKKSHI dhe DIKMA, të paktën dy javë para takimit, lidhur me agjendën e takimit të parashikuar, tematikën dhe qëllimin, duke evidentuar qartë detyrimet e MASR dhe koordinojnë me ta për qëndrimin, që duhet të mbajnë në emër të MASR;
  - g. raportojnë pranë AKKSHI dhe DIKMA jo më vonë se shtatë ditë pas zhvillimit të takimit duke dërguar në formë elektronike një relacion të përmbledhur deri dy faqe (në format elektronik), i cili të përmbajë të dhënat për qëllimin dhe objektin e takimit, për ecurinë e bisedimeve, për rekomandimet përkatëse për çështjet e diskutuara, sugjerimet për hapa të mëtejshëm për t'u ndërmarrë dhe planifikimin e punës në vijim;
  - h. raportojnë brenda datës 30 qershor dhe 31 dhjetor të çdo viti pranë AKKSHI-së mbi pjesëmarrjen e tyre në takimet sipas fushës tematike të kërkimit shkencor që përfaqësojnë, dhe gjithë punën e kryer si përfaqësues në komitetet H2020 dhe ERA, sipas treguesve të përcaktuar në shtojcën 6 bashkëlidhur, si dhe përcjellin propozimet përkatëse në kuadër të përmirësimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin H2020 dhe rritjes së numrit të aplikimeve dhe përfituesve të projekteve.
4. Për përfaqësuesit në komitetet e programit H2020 dhe në komitetet ERA, të gjitha shpenzimet për pjesëmarrjen në aktivitetet jashtë vendit do të mbulojnë nga AKKSHI nëpërmjet fondit të alokuar nga MASR për këtë qëllim. Parashikohen afërsisht katër takime në vit.

SHTOJCA 1  
KOMITETET E PROGRAMIT H2020 DHE KOMITETET ERA  
(EUROPEAN RESEARCH AREA COMMITTEES)

Komitetet e programit Horizon 2020

1. European Research Council, Marie Skłodowska-Curie Actions, Future and Emerging Technologies
2. Research Infrastructures
3. Information and Communication Technologies)
4. Nanotechnologies, Advanced Materials, Biotechnology, Advanced Manufacturing and Processing
5. Health, Demographic Change and Well-being
6. Food Security, Sustainable Agriculture and Forestry, Marine, Maritime and Inland Water Research, and the Bioeconomy
7. Secure, Clean and Efficient Energy
8. Smart, Green and Integrated Transport
9. Climate Action, Environment, Resource Efficiency and Raw Materials
10. Europe in a Changing World - Inclusive, Innovative and Reflective Societies
11. Secure Societies – Protecting Freedom and Security of Europe and its Citizens

Komitetet ERA

1. SWGHRM – Standing Working Group on Human Resources and Mobility
2. SFIC - Strategic Forum on International Science and Technology Cooperation
3. GPC - High Level Group on Joint Programming

SHTOJCA 1A

**Komitetet e programit Horizon 2020**

**1. European Research Council, Marie Skłodowska-Curie Actions, Future and Emerging Technologies**

Ky komitet siguron trajnime novatore kërkimore, mundësi për karrierë dhe shkëmbime të njohurive përmes mobilitetit ndërkufitar dhe ndërsektorial të kërkuesve, për t'i përgatitur ata më mirë për sfidat aktuale dhe të ardhshme të shoqërisë. Veprimet Marie Skłodowska-Curie janë të hapura për të gjitha fushat e kërkimit shkencor dhe novacionit që trajtohen në kuadër të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian, nga kërkimi shkencor bazë deri tek shërbimet e marketingut dhe novacionit. Më shumë info gjendet në linkun

<https://www.forskningsradet.no/en/Funding/H2020MSCA/1254015236559>

**2. Research Infrastructures**

Qëllimi i këtij komiteti është që të sigurojë pranimin e kërkuesve evropianë në infrastrukturën kërkimore të nivelit botëror. Komisioni Evropian nuk konsideron vetëm pajisjet kryesore shkencore si pjesë e infrastrukturës kërkimore, por përfshin në të gjithashtu edhe grupe instrumentesh, burimesh të bazuara në njohuri si arkivat, bazat e të dhënave, infrastrukturën elektronike (e-Infrastruktura) si rrjetet informatike dhe infrastrukturën e komunikimit. Mbështeten infrastruktura kërkimore ekzistuese dhe të reja. Më shumë info gjendet në linkun

<https://www.euresearch.ch/en/european-programmes/horizon-2020/excellent-science/research-infrastructures/>  
<http://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/h2020-section/research-infrastructures-including-e-infrastructures>

### **3. Information and Communication Technologies**

Ky komitet mbështet novacionin dhe konkurrueshmërinë ndërmjet një game të gjerë tregjesh dhe sektorësh private dhe publikë. Më shumë info gendet në

<https://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/h2020-section/information-and-communication-technologies>

### **4. Nanotechnologies, Advanced Materials, Biotechnology, Advanced Manufacturing and Processing**

Ky komitet mbështet zhvillimin e teknologjive duke nxitur novacionin në shumë sektorë. H2020 i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të aftësive industriale evropiane. Kjo pjesë e programit mbulon fusha të ndryshme:

- Nanoteknologji
- Materialet e avancuara
- Prodhimi dhe përpunimi i avancuar
- Bioteknologji

Më shumë informacion gjendet në linkun e mëposhtëm

<http://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/h2020-section/nanotechnologies-advanced-materials-advanced-manufacturing-and-processing-and>

### **5. Health, Demographic Change and Well-being**

Duke iu përgjigjur kësaj sfide, kërkimi shkencor dhe novacioni në kuadrin e Horizon 2020 është një investim në shëndet më të mirë për të gjithë duke synuar t'i mbajë njerëzit e moshuar aktivë dhe të pavarur për një kohë të gjatë. Ky komitet përkrah zhvillimin e ndërhyrjeve të reja, më të sigurt dhe më efektive. Kërkimi shkencor në këtë fushë kontribuon në qëndrueshmërinë e sistemit shëndetësor dhe të kujdesit. Projektet shkencore në këtë fushë do të:

- ndihmojnë për të kuptuar më mirë arsyet dhe mekanizmat bazë të shëndetit, plakjen dhe sëmundjet;
- përmirësojnë aftësitë për të kontrolluar shëndetin dhe për të parandaluar, zbuluar dhe trajtuar sëmundjet;
- mbështesë personat e moshuar që të mbeten aktivë dhe të shëndetshëm;
- provojë dhe tregojë modele të reja dhe mjete për shëndetin dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor.

Më shumë informacion gjendet në linkun e mëposhtëm

<http://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/h2020-section/health-demographic-change-and-wellbeing>

### **6. Food Security, Sustainable Agriculture and Forestry, Marine, Maritime and Inland Water Research, and the Bioeconomy**

Përdorimi më i mirë dhe i rinovueshëm i burimeve biologjike duhet të kalojë një fazë të ndërmjetme drejt prodhimit fillestar të qëndrueshëm dhe sistemeve të përpunimit. Këto sisteme do duhet të prodhojnë më shumë ushqime, fibra dhe produkte të tjera me bazë biologjike me sa më pak ushqim/produkt bazë, sa më pak ndikim mjedisor dhe *emetime gazrash serrë*, me shërbime ekosistemesh më të përmirësuara, pa plehra dhe me përfitime për shoqërinë.

Bujqësia, pylltaria, peshkimi dhe prodhimet ujore janë pjesë përbërëse e ekonomisë dhe shoqërisë evropiane. Duke u bazuar në përdorimin e burimeve natyrore të kufizuara, këta sektorë prodhojnë dhe përpunojnë burime biologjike për të përmbushur kërkesat e konsumatorëve dhe një gamë të gjerë industrish ushqimore, energji bio dhe produkte me bazë bio. Ndërkohë që këta sektorë nxisin mbështetjen e Evropës në burimet e veta, sigurojnë vende pune dhe mundësi biznesi që janë

themelore për zonat rurale, bregdetare dhe detare, ata përballen edhe me sfida të rëndësishme të cilat kërkojnë zgjidhje të bazuara në shkencë dhe novacion. Më shumë informacion gjendet në linkun e mëposhtëm

<http://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/h2020-section/food-security-sustainable-agriculture-and-forestry-marine-maritime-and-inlandwater>

## **7. Secure, Clean and Efficient Energy**

Sfida e energjisë është ideuar të mbështesë fazën kalimtare drejt një sistemi energjie të besueshëm, të qëndrueshëm dhe konkurrues. Për këtë, duhet të kapërcehen një sërë sfidash, si p.sh. burime gjithnjë e më të pakta, nevoja në rritje për energji dhe ndryshimet klimatike. Sfida e energjisë përshin shtatë objektiva specifike dhe fusha kërkimi shkencor:

- Zvogëlimi i përdorimit të energjisë dhe gjurmëve të karbonit
- Furnizim energjie elektrike me shpenzime të ulëta dhe me sasi karboni të ulët
- Lëndë djegëse të tjera dhe burime të lëvizshme energjie
- Një rrjet elektrik i vetëm dhe i zgjuar për Evropën
- Njohuri dhe teknologji të reja
- Vendimmarrje e fuqishme dhe angazhim publik
- Rritje e tregut të energjisë dhe novacion TIK

Më shumë informacion gjendet në linkun e mëposhtëm

<http://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/h2020-section/secure-clean-and-efficient-energy>

## **8. Smart, Green and Integrated Transport**

Kjo sfidë synon të nxisë konkurrencën ndërmjet industrive evropiane të transportit dhe të krijojë një sistem transporti evropian që përdor me efektivitet burimet, që nuk dëmton klimën dhe mjedisin, sistem transporti të sigurtë dhe të vazhdueshëm për të mirën e gjithë qytetarëve, ekonominë dhe shoqërinë. Më shumë informacion gjendet në linkun e mëposhtëm

<http://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/h2020-section/smart-green-and-integrated-transport>

## **9. Climate Action, Environment, Resource Efficiency and Raw Materials**

Veprimtaritë në këtë sfidë do të ndihmojnë në rritjen e konkurrencës evropiane, sigurinë e lëndëve të para dhe përmirësimin e mirëqenies. Në të njëjtën kohë ato do të sigurojnë integritet mjedisor, aftësi ripërtëritëse dhe qëndrueshmëri me qëllim mbajtjen e mesatares së ngrohjes globale nën 2°C, të mundësojnë që ekosistemet dhe shoqëria të përshtatet me ndryshimet klimatike dhe ndryshime të tjera mjedisore. Ky komitet do të mbështesë financimin në shkencë dhe novacion me këto objektivat specifike:

- Arritja e një shoqërie dhe ekonomie të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike dhe që përdor me efikasitet burimet dhe ujin,
- mbrojtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ekosistemeve, dhe
- një furnizim dhe përdorim të qëndrueshëm të lëndëve të para, në mënyrë që të plotësojnë nevojat e një popullsie botërore në rritje brenda kufijve të qëndrueshëm të burimeve natyrore të planetit dhe ekosistemeve.

Më shumë informacion gjendet në linkun e mëposhtëm

<https://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/h2020-section/climate-action-environment-resource-efficiency-and-raw-materials>

## **10. Europe in a Changing World - Inclusive, Innovative and Reflective Societies**

Evropa përballlet me sfida të mëdha në uljen e pabarazisë dhe përjashtimin social. 80 milionë njerëz janë në rrezik varfërie dhe 14 milionë të rinj nuk ndjekin as shkollë e as trajnim, e nuk janë as në punë. Nuk është kapërcyer ende kriza ekonomike, e cila çoi në kuota papunësie prej 12% në përgjithësi dhe 20% te të rinjtë. Reduktimi i pabarazive dhe përjashtimit social në Evropë janë sfida kritike për të ardhmen e Evropës. Në të njëjtën kohë, ka potencial të madh për Evropën përmes

mundësive të ofruara, për shembull, nëpërmjet formave të reja të novacionit dhe angazhimit të qytetarëve. Mbështetja e shoqërive gjithëpërfshirëse, novatore dhe reflektuese është parakusht për një integrim të qëndrueshëm evropian. Kërkimi shkencor dhe novacioni në këtë fushë do të trajtojë përjashtimin social, diskriminimin dhe format e ndryshme të pabarazive, do të kërkojë forma të reja të novacionit dhe forcojë bazën e provave për Unionin e Novacionit, Zonën Evropiane të Kërkimit dhe politika të tjera të rëndësishme evropiane, dhe së fundmi, do të trajtojë çështje të kujtesës, identiteteve, tolerances dhe trashëgimisë kulturore. Me pak fjalë, kjo sfidë shoqërore e programit Horizon 2020 synon të nxisë një kuptim më të gjerë të Evropës, duke ofruar zgjidhje dhe mbështetje për shoqëritë evropiane përfshirëse, novatore dhe pasqyruese me një sektor publik novator në kuadrin e ndryshimeve të padëgjuaara më parë dhe të ndërvarësive globale në rritje. Më shumë informacion gjendet në linkun e mëposhtëm

<http://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/h2020-section/europe-changing-öorld-inclusive-innovative-and-reflective-societies>

## **11. Secure Societies – Protecting Freedom and Security of Europe and its Citizens**

Kjo sfidë ka të bëjë me ndërmarrjen e veprimtarive kërkimore dhe novatore të nevojshme për të mbrojtur qytetarët, shoqërinë dhe ekonominë, infrastrukturën dhe shërbimet, zhvillimin, qëndrueshmërinë politike dhe mirëqenien. Synimet kryesore të kësaj sfide janë:

- të rrisë qëndrueshmërinë e shoqërisë kundër fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu, duke filluar nga krijimi i mjeteve të reja për administrimin e krizave deri te zhvillimi i zgjidhjeve të reja për mbrojtjen e infrastrukturës kritike;
- të luftojë krimin ose terrorizmin duke filluar nga mjetet e reja mjeko-ligjore e deri tek mbrojtja kundër eksplozivëve;
- të përmirësojë sigurinë e kufijve, duke filluar nga mbrojtja e përmirësuar e kufijve detarë deri tek siguria e furnizimit zinxhir dhe të mbështesë politikat e BE-së për sigurinë e jashtme duke përfshirë parandalimin e konflikteve dhe ruajtjen e paqes;
- të ofrojë siguri më të madhe në internet, duke filluar nga shpërndarja e sigurtë e informacionit e deri te modelet e reja të sigurisë.

Më shumë informacion gjendet në linkun e mëposhtëm

<http://ec.europa.eu/programmes/horizon2020/en/h2020-section/secure-societies-%E2%80%93-protecting-freedom-and-security-europe-and-its-citizens>

## **KOMITETET ERA**

### **1. SWGHRM – Standing Working Group on Human Resources and Mobility**

Grupi i Përhershëm i Punës për Burimet Njerëzore dhe Mobilitetin i ERAC mbështet zbatimin dhe mbikëqyrjen e ecurisë së nismës EU2020 për Unionin e Novacionit, si dhe zbatimin e Zonës Evropiane të Kërkimit në fushat që lidhen me karrierën dhe mobilitetin e kërkuesve në nivel të BE-së dhe kombëtar (p.sh. Karta Evropiane për Kërkuesit dhe Kodi i Sjelljes për punësimin e Kërkuesve, Trajnimi Novator i Doktoratës, Zhvillimi i Karrierës, veprimtaritë EURAXESS), si dhe me aftësinë tërheqëse të Evropës për kërkuesit në përgjithësi.

Aktualisht, SWGHRM përqendrohet në çështjet e mëposhtme për zhvillimin e ERA-s:

- i) ndjekja e prioritetit 3 të ERA-s: treg i hapur pune për kërkuesit;
- ii) punësim i hapur, i qartë dhe i bazuar në meritë;
- iii) inkurajimi dhe zhvillimi i karrierave kërkimore dhe qarkullimi ndërsektorial i kërkuesve;
- iv) bashkëpunimi midis ERA-s dhe EHEA-s (European Higher Education Area) me Agjendën e shkencës së hapur dhe barazinë gjinore.

Anëtarët e Grupit të Përhershëm të Punës japin informacion mbi planet e përgjithshme të hartuara në nivel kombëtar për zbatimin e Udhërrëfyesit të ERA-s. Ata gjithashtu raportojnë rregullisht mbi veprimtaritë e ndërmarra ose të parashikuara për zbatimin e këtyre planeve, si dhe për zhvillimet në lidhje me aktivitetet e tjera në vazhdim që lidhen me kërkuesit. Grupi i punës mbledhet zakonisht katër herë në vit. Më shumë informacion gjendet në linkun e mëposhtëm

<https://era.gv.at/directory/25>



## **2. SFIC - Strategic Forum on International Science and Technology Cooperation**

Forumi Strategjik për Bashkëpunimin Ndërkombëtar Shkencor dhe Teknologjik (SFIC) është një grupim i dedikuar i ERAC. Objektivi i tij është të lehtësojë zhvillimin e mëtejshëm, zbatimin dhe mbikëqyrjen e shtrirjes ndërkombëtare të ERA-s. Në praktikë, kjo nënkupton ndarjen e informacionit dhe këshillimin midis partnerëve (Shteteve Anëtare dhe Komisionit) me qëllim identifikimin e prioriteteve të përbashkëta, të cilat mund të çojnë në nisma të bashkërenduara ose të përbashkëta. Grupi gjithashtu synon bashkërendimin e aktiviteteve dhe qëndrimeve përkundrejt vendeve të treta dhe brenda forumeve ndërkombëtare. SFIC zhvillon rreth katër takime në vit. Më shumë informacion gjendet në linkun <https://era.gv.at/directory/35>

## **3. GPC - High Level Group on Joint Programming**

GPC (Groupe de haut niveau pour la Programme Conjointe, High Level Group on Joint Programming) është një strukturë e dedikuar e Komitetit të Zonës Evropiane të Kërkimit (ERAC). GPC u krijua nga Këshilli i Konkurrencës në dhjetor 2008 për të zbatuar një proces të udhëhequr nga Shtetet Anëtare për të rritur bashkëpunimin e tyre në fushën e kërkim-zhvillimit, me qëllim që të përballojnë më mirë sfidat shoqërore të nivelit evropian ose botëror, ku kërkimi shkencor publik luan një rol kyç. Ky grup zhvillon katër takime në vit. Më shumë informacion gjendet në linket e mëposhtme

[http://ec.europa.eu/research/era/what-joint-programming\\_en.htm](http://ec.europa.eu/research/era/what-joint-programming_en.htm)

<https://www.era-learn.eu/gpc>

SHTOJCA 2  
KRITERET E PËRCAKTIMIT SI PËRFAQËSUES NË KOMITETET E PROGRAMIT H2020  
DHE ERA (EUROPEAN RESEARCH AREA)

- a. të pranojë me vullnet të lirë të kryejë rolin e përfaqësuesit në komitetet e programit H2020 dhe ERA,
- b. të ketë përvojë në fushën e kërkimit të H2020 për të cilën kërkon të veprojë si përfaqësues,
- c. të ketë përvojë në projekte kërkimore kombëtare apo ndërkombëtare,
- d. të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze,
- e. të njohë mirë planin e punës aktual të fushës tematike që përfaqëson,
- f. të ketë aftësi të mira prezantimi dhe komunikimi,
- g. të jetë i motivuar të kryejë punën si përfaqësues në H2020,
- h. të jetë i aftë të punojë në grup,
- i. të jetë i disponueshëm dhe kontaktueshëm nëpërmjet email-it dhe telefonit gjatë orarit të punës, për të gjithë të interesuarit,
- j. të jetë i disponueshëm për të marrë pjesë në takime kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të detyrës që i ngarkohet,
- k. të mos jetë në konflikt interesi në kryerjen e detyrës që i kërkohet,
- l. të jetë i familjarizuar me objektivat, principet dhe përmbajtjen e fushës tematike të programit për të cilin aplikon si përfaqësues.





(EMRI I INSTITUCIONIT)

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ 2018

**AUTORIZIM**

Autorizohet Z./Znj. \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_ në institucionin tonë, të veprojë si përfaqësues kombëtar në komitetet e programit H2020 dhe komitetet ERA (European Research Area) në kuadër të programit Horizon 2020 – Programi i BE-së për Kërkim dhe Novacion.

(TITULLARI I INSTITUCIONIT)

\_\_\_\_\_

## SHTOJCA 5

### AUTORIZIM PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË KONTAKTIT

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_  
emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. \_\_\_\_\_ autorizoj Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe Agjencinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin të publikojnë emrin tim dhe të dhënat e mia të kontaktit si më poshtë vijon - në kuadër të rolit si përfaqësues në komitetet e programit Horizon 2020 dhe ERA - në faqet e tyre të internetit. Jap gjithashtu miratimin tim që këto të dhëna të publikohen edhe në databazën on-line të Komisionit Evropian.

Emër Mbiemër \_\_\_\_\_  
përfaqësues në komitetet e programit Horizon 2020 dhe ERA \_\_\_\_\_  
Institucioni punëdhënës \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Numër telefoni \_\_\_\_\_  
Celular \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi

SHTOJCA 6  
TREGUESIT PËR VLERËSIMIN E PUNËS  
SË PËRFAQËSUESVE NË KOMITETET E PROGRAMIT H2020 DHE ERA

1. Rritja e rolit dhe përfaqësimit të vendit në komitetin përkatës,
2. Pjesëmarrja dhe raportimi periodik pas çdo pjesëmarrje lidhur me zhvillimet në këto struktura,
3. Përcjellja e opinionit dhe mendimit të Shqipërisë si vend pjesëmarrës gjatë diskutimeve për çështje të ndryshme,
4. Vendosja e kontakteve me homologë dhe krijimi i lidhjeve për shkëmbim informacioni,
5. Nxitja e ndryshimit dhe përputhjes së politikave kombëtare me politikat e kërkimit shkencor të BE përmes informimit të KALKSH,
6. Raportimi periodik dhe i plotë, si dhe përcjellja e sugjerimeve AKKSHI-së, në lidhje me fushën përkatëse mbi politikat dhe/ose hapat që duhet të ndërmarrë vendi ynë në këto fusha.